

RAPORT TEKNIK

Rehabilitimi i Kanaleve te kullimit ne Gjocaj

1. TE PERGJITHSHME

Kanalet e fshatit Rrumbullak Gjocaj ndodhen ne Jug-Perendim te Qytetit te Peqinit dhe ne krahun e djathte te rruges Peqin-Elbasan. Nga konstatimet e kryera vihet re se keto kanale kane dale jashte funksionit si pasoje e mbushjes me aluvione dhe e bimesise te dendur te zhvilluar ne shtratin e tyre si dhe bllokime te veprave te artit pergjate kanalit. Si pasoje keto kanale prurja qe percjellin keto kanale eshte minimale duke bere qe gjate reshjeve te shiut here pas here kjo zone te permytet dhe dhe te mos kryeje funksionin e kullimit te fushave pereth.

Ne keto kushte shihet e domosdoshme nderhyrja per pastrimin dhe largimin e aluvioneve nga shtrati i kanaleve dhe kthimi I tyre ne gjendje funksionale me kapacitet te plote.



PROJEKT ZBATIMI

Ky raport teknik shpjegon nderhyrjet teknike te parashikuara per nje faze emergjente per objektin “Rehabilitim I kanalit te kullimit Rrumbullak, Gjocaj”.Ne kete faze parashikohet pastrami i Kanalit ne fshatin Rrumbullak te Njwsisw Administrative Gjocaj
Autoritet Perfitues i ketij objekti eshte Bashkia Peqin.

Projekti parashikon nje nderhyrje emergjente per pastrimin e Kanaleve te kullimit ne nje gjatesi prej 1184 ml.

Gjate rikonjicioneve ne objekt u evidentuan problemet kyce, si dhe u moren ne konsiderate faktoret e meposhtem per zgjidhjen e projektit:

- Seksioni ekzistues eshte i mbushur shume me aluvione gje qe ka shkaktuar dhe permytjet e vazhdueshme ne zonat perreth.
- Veprat e artit te vendosura pergjate kanalit kryesisht jane te bllokuara dhe si dhe disa prej tyre nuk jane llogaritur per prurje maksimale.
- Aktualisht fondet e vena ne dispozicion jane te kufizuara, prandaj dhe parashikohet vetem pastrimi i kanaleve ne nje gjatesi prej 1184ml.

Me miratim edhe te autoritetit perfitues per zgjidhjen e detajuar teknike jane pranuar elementet e meposhtem te projektimit:

- Kanali i marre ne studim do te kete nje gjatesi prej 1184ml.
- Fokus i projektit eshte pastrimi dhe riseksionimi aq sa eshte i mundur i kanalit te fshatit Rrumbullak, ne menyre qe te lehtesohen sadopak kushtet ekzistuese me te cilen perballen banoret dhe fermeret.

Punimet e parashikuara ne kete projekt-zbatimi jane si me poshte vijon:

- Pastrimi i bimesise
- Riseksionimi i kanalit te perroit
- Pastrimi i aluvioneve
- Germim dheu nw kanal

Kjo nderhyrje emergjente mer parasysh situaten faktike mjaft problematike me pronat perreth kanali, godinat ne disa zona si dhe infrastrukturen rrugore qe ndodhet kanalit.

TE DHENA TE TJERA TE DOMOSDOSHME

Per realizimin e ketij projekti nje nder te dhenat kyce ishte dhe hartimi i relievit dixhital topografik. Studimi topografik konsistoi ne:

Studimi topografik i trasese se kanaleve ne nje fasho deri ne 20 m ne secilen ane te tij.

Te gjitha te dhenat gjeometrike, topografike te elementeve te kanaleve ekzistuese u verifikuan:

U be ndertimi i modelit digital te terrenit duke percaktuar me detaje te hollesishme te gjithe elementet perberes te terrenit.

Transferimi i te dhenave topografike ne sistemet CAD

Per kete qellim u vendos qe terreni te rilevohet ne te gjithe gjatesine e saj. Duke marre pika per hartimin e profilave terthore dhe ate gjatesore.

Per matjet ne objektin e lartepemendur u perdor Rover Trimble dhe 2 GPS. Paisjet topografike te perdorura jane te teknologjise se fundit dhe me sakte si te larte duke permbushur te gjitha kerkesat e detyres se projektimit.

Kanali Kullimit Fshati Rrumbullak ,Njesia Administrative Gjocaj

Kanali ka nje gjatesi prej 1184m dhe shtrihet ne nje zone bujqesore me pak objekte banimi pereth tij.



*Horografia e Kanalit
Rrumbullak*

Kanali ne fshatin Rrumbullak do te beje te mundur kullimin e gjithe fushes pereth duke beret e mundur shmangien e problemeve te permytjes ne te ardhmen.

Parametrat teknik te kanalit jane si me poshte vijon:


Baza e seksionit :4m

Lartesia e seksionit :2 m

Pjerresi e skarpatave: 1deri 1.3

Franko: 0.3m

Pjerresia e kanalit : 0.2 – 0.8 %



Kanali do te jete trapezoidal pa veshje dhe lartesia maksimale e ujit ne kanal do te jete 170cm. Koeficienti i ashpersise Manning ($n=0.035$) eshte marre per kushtet mesatare te jetgatesise se kanalit ku do te ruhet seksioni aktual por do te kemi zhvillimin e bimesise ne shtratin e tij.

Per ndertimin e kanaleve nje rendesi te madhe ka edhe zgjidhja e koeficientit te skarpates e cila varet nga lloji i formacionit te tokes ku do te vendoset kanali. Ne rastin tone ku formacioni i tokes perbehet nga argjila, lese apo suargjila do te pranojme nje koeficient skarpate nga 1 deri 1.3.

Per pjerresine mesatare te kanalit 0.5% dhe per parametrat e mesiperme te kanalit jane bere llogaritjet hidraulike ne excel per shtretit e hapur dhe me poshte paraqiten rezultatet ne forme tabelare.

Kanali Nr.1		
Prurja e kerkuar (l/s)	Q =	10370.00
Gjeresia e fundit te kanalit (cm)	b =	160.00
Pjerresia e kanalit (fundi i kanalit)	i =	0.005
Pjerresia e skarpates se kanalit	m =	1
Koeficienti i ashpersise (Manning)	n =	0.035
Thellesia e ujit ne kanal dhene me tentativa deri sa $Q=Q_{ca}$ (cm)	h =	170.000
Siperfaqja e lagur (m^2)	S =	5.61
Perimetri i lagur (m)	P =	6.41
Gjeresia e siperme (cm)	B =	500.0
Rezja hidraulike	R =	0.88
Parametri chezy	C =	27.94
Prurja e kanalit te marre ne llogaritje (l/s)	$Q_{ca} =$	10371.91
Shpejtesia e levizjes se ujit ne kanal (m/s)	V =	1.85

Bazuar ne llogaritjet hidraulike rezulton se kapaciteti transportues i kanalit eshte 10371 l/sek =10.3 m³/sek.

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT
DHE
ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**